



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

BURSA PËR STUDIME PASUNIVERSITARE

NË KORENË E JUGUT PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018

Shkolla KDI për "Politikat dhe Menaxhimin Publik" në Korenë e Jugut, (*KDI School of Public Policy and Management*), për vitin akademik 2017-2018, ofron bursa studimi pasuniversitare për zyrtarë/nëpunës të administratës publike në programet e studimit Master/ Doktoraturë në fushat e mëposhtme:

- Master/ Phd për Politikat Publike;
- Master/ PhD për Politikat e Zhvillimit;
- Master për Menaxhimin Publik

Misioni i kësaj shkolle është të trajtojë dhe përgatisë drejtues të së ardhmes në sektorët publikë dhe privatë që përshtaten plotësisht me ndryshimet ekonomike.

Kandidatët pasuniversitare që dëshirojnë të ndjekin këto studime duhet të kenë kualifikimin e domosdoshëm. Ata duhet të kenë përfunduar studimet në programe bachelor ose master pranë universiteteve ose shkollave të larta në Republikën e Shqipërisë ose jashtë vendit. Kandidatët, gjithashtu, duhet t'i nënshtrohen testimit ndërkombëtar: TOEFL, IELTS, ose TOEIC, duke qene se kurset zhvillohen në gjuhën angleze.

Për një informacion më të detajuar për kushtet e aplikimit, referojuni adresave në vijim:

Admissions Office

KDI School of Public Policy and Management

263 Namsejong-ro, Sejong, 30149, Republic of Korea

Phone: (Int'l) 82-44-550-1281 or 1220 ; (Korean) 82-44-550-1263 or 1220

E-mail: internationaladmissions@kdis.ac.kr

Website: <http://admissions.kdischool.ac.kr>

Afati i fundit për aplikim është **data 25 Tetor 2016.**

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE